



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

VENDIM

Nr. 21, datë 27.01.2021

PËR KOMANDIMIN E MAGJISTRATIT

Këshilli i Lartë i Prokurorisë, mbështetur në nenin 149 germa a) të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenet 53 pika 2 dhe 54 dhe 55 të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në nenet 164 pika 8, 166 pika 2, 189 pika 1 germa a) dhe 209 të Ligjit nr.115/2016 “Për Organet e Qeverisjes së Sistemit të Drejtësisë”, i ndryshuar, Këshilli i Lartë i Prokurorisë:

V E N D O S I:

1. Komandimin e Znj. **Lindita Ziguri (Male)**, prokurore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, në pozicionin e Inspektorit pranë Inspektoratit të Lartë të Drejtësisë.
2. Periudha e komandimit do të jetë 5 (pesë) vjet dhe fillon nga data 08.02.2021.
3. Të njoftohen për këtë vendim Znj. Lindita Ziguri (Male), Prokurori i Përgjithshëm, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë dhe Inspektorati i Lartë i Drejtësisë.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë të Prokurorisë.

KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

KRYETARI
GENT IBRAHIMI

ZV/KRYETAR
ALFRED BALLA

ANËTAR
KOSTAQ BELURI

ANËTAR
BUJAR SHESHI

ANËTAR
NURIHAN SEITI

ANËTAR
SANDËR BECI

ANËTAR
VATË STAKA

ANËTAR
TARTAR BAZAJ

ANËTAR
ESMERALDA KESHI